

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIERKICJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr. lqj/Br. str. 144

Date/Datum 31. 10. 2017

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e tetë - VIII, e rregullt, e mbajtur më datë 20.09.2017, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Fadil Krasniqi - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Qerim Gara - Zëvendëskryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, Nazmi Kelmendi, Milaim Berjani, Remzi Shala, Bastri Sllamniku, Bedri Krasniqi, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Shaban Ademi, Vjollca Konjusha, Mirishahe Berisha, Arjeta Jashari, Sazana Statovci, Naser Graiçevci, Ridvan Krasniqi, Fazile Sejdiu, Aida Alimi, Sabit Godeni, Migjen Kolshi, Hasan Krasniqi, Trandolina Duli, Ali Ismaili, Fitore Simnica, Elmi Shabani dhe Miroslav Veličković.

Mungon: Ylber Islami.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Jakup Dumani - Nënkyetar i Komunës, Halil Qerimi - Nënkyetar i Komunës për Komunitete, Nuriye Fazliu - Drejtore e Administratës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Jakup Tërnavë - Drejtor i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Mimoza Kolshi - Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit dhe Afrim Krasniqi - Drejtor i Inspektoratit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e KFOR-it dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e datës 31.07.2017.
2. Dhënia e opinioneve për punën e anëtarëve të Kuvendit të Komunës për mandatin zgjedhor 2013-2017.
3. Propozim për shqyrtimin e 'Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmuorin e parë të vitit 2017'.
4. Propozim për shqyrtimin e Buxhetit të planifikuar për vitin 2018.
5. Shqyrtimi i dytë i 'Projekt-Planit për zhvillimin e arsimit 2017-2019'.
6. Shqyrtimi i dytë i 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. Fatmir Krasniqi'.
7. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për Shërbyesin Civil Sahit Sopjani.

8. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për Shërbyesin Civil Adem Kutllovci.
9. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm të punëtorit arsimor Ramadan Bislimi.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kemi një propozim nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa që të bëhet një ndryshim në pikat e rendit të ditës. Në vend të pikës së dytë 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', anëtarët e Kuvendit të Komunës të japin opinionet dhe mendimet e veta për punën katër vjeçare, e cila është bërë në këtë Kuvend. Kërkoj nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të deklarojnë për rendin e ditës së propozuar me ndryshimin e bërë. Hap diskutimin.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne vazhdojmë ta kundërshtojmë rendin e ditës. Nëse përbërja e shihet të arsyeshme, që para aprovimit të rendit të ditës, para se të kalojmë në temë pune, të na jap fjalën qoftë përmes grupeve parlamentare, qoftë individualisht në mënyrë që të themi disa fjalë përshëndetëse. Do të ishte mirë që mbledhja e sotme të ishte vetëm solemne, e jo me materiale e dokumente. Nëse më lejohet unë do të vazhdoja me një përshëndetje të shkurtë nëse jo atëherë vazhdojmë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në pikën e dytë ju mund të jepni opinionet dhe të bëni përshëndetjet tuaja pasi që është mbledhja e fundit e Kuvendit të Komunës. Prandaj, s'keni nevojë të filloni tani, po shkojmë sipas rendit të ditës dhe në kuadër të pikës së dytë 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', do ta merr fjalën kushdo që ka dëshirë e jo vetëm Shefat e Grupeve Parlamentare. Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për aprovimin e rendit të ditës së propozuar për këtë mbledhje, me propozimin shtesë nga mbledhja e Kuvendit për Politikë e Financa për ndryshimin e pikës së dytë 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' me dhënien e opinioneve dhe mendimeve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës për mandatin zgjedhor 2013-2017.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', gjashtë 'kundër' dhe asnjë 'abstenim', gjithsej njëzet e një (21) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e datës: 31.07.2017.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 31.07.2017. Hap diskutimin.

Nazmi Kelmendi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së, konsideroj se ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e rregullt, e mbajtur më 31.07.2017, i përmban të gjitha diskutimet që kanë rrjedh në mbledhje dhe propozojmë që i njëjti të aprovohet.

Trandolina Duli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. E kam filluar këtë mandat duke e kundërshtuar ekstraktin e procesverbalit dhe po e përmbyll në të njëjtën mënyrë, duke e shprehur qëndrimin tim që nuk janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës për publikimin e audioincizimeve.

Naser Graiçevci: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, jemi kundër aprovimit të ekstraktit të procesverbalit. Si do ta vlerësoj qytetari punën që e kemi bërë në Kuvendin e Komunës, kur dihet që për katër vjet rresht, ata nuk kanë pasur mundësi të dëgjojnë zërin tonë, sepse nuk janë publikuar audioincizimet.

Pasi që diskutime dhe plotësime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për aprovimin e ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë: 31.07.2017.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe një 'abstenim', gjithsej njëzet e katër (24) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e datës: 31.07.2017.

Pika e dytë (2) - Dhënia e opinioneve për punën e anëtarëve të Kuvendit të Komunës për mandatin zgjedhor 2013-2017.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën për: 'Dhënien e opinioneve për punën që është bërë në Kuvendin e Komunës', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të marrin fjalën.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Nuk dua të filozofoj në këtë mbledhje të fundit, mirëpo dua të them që për katër vite sa kam qenë këtu si anëtarë, kam vepruar në bazë të një parimi, të cilin unë e kam pas objektiv. Ne si Parti e Drejtësisë nuk kemi pas mundësi t'i ndryshojmë gjërat me një lëvizje të dorës, sepse nuk kemi qenë pjesë, me marrëveshje, e këtij ekzekutivi. Ne kemi pas marrëveshje gojore me të gjitha subjektet politike këtu, në bazë të së cilës, ne si parti nëse e shohim që janë duke punuar mirë i mbështesim qoftë opozitën, qoftë pozitën. Ndërsa nëse e shohim se janë duke punuar keq, ne si Parti e Drejtësisë duhet të reflektojmë në raport me ta, qoftë me opozitën, qoftë me pozitën, qoftë me Kryetarin apo këdo tjetër. Mendoj se në bazë të këtij parimi unë shpeshherë e kam kritikuar edhe Kryetarin edhe ekzekutivin, por edhe të tjerët, aty ku unë kam menduar se e kanë gabim. Për mua është shumë e rëndësishme që qëllimi ka qenë i pastër, si i imi po ashtu edhe i znj. Fitore Simnica, koleges sime partiake. Ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin gjatë këtij mandati katër vjeçar. Po lë shumë zbrazëtira, në kontekstin e asaj që kjo Komunë duhet të punoj më shumë, ky ekzekutiv duhet të ndryshoj më shumë. Sipas mendimit tim, ky ekzekutiv duhet të punoj më shumë në dy segmente kryesore, në arsim dhe në shëndetësi, të cilat po ashtu janë edhe kërkesa të shumë qytetarëve. Mendoj që në këto dyja duhet të fokusohet më tepër ekzekutivi, në arsim dhe në shëndetësi, sepse mendoj se këtu jemi më keq. Po ashtu dua t'iu informoj se unë nuk jam pjesë e asnjë liste të subjekteve politike, pra nuk do të marr pjesë dhe nuk do të garoj në garën politike të fundit. Ju uroj suksese atyre që do të vinë në katër vitet e ardhshme. Për mua është njerëzore t'iu kërkoj falje të gjithëve, nëse unë s'ia kam qëlluar me punën time, në të kundërtën unë mburrem me punën që kam bërë. Suksese të gjithëve!

Nazmi Kelmendi: Në emër timin personal dhe në emër të kolegëve të mi, ju falënderoj për bashkëpunimin e mirëfilltë, njerëzor dhe të sinqertë që e keni pas si kolegë, si dhe për punën që e keni bërë, për t'i shtyrë çështjet në interes të qytetarëve, në bazë të mandatit që e kemi pas. Kjo periudhë mandatare besoj që ka qenë një periudhë konstruktive, ku janë ngrit të gjitha çështjet, janë debatuar në mënyrë demokratike, të bazuara në planin e punës që e kemi pas, të cilin e kemi aprovuar bashkërisht. Besoj që ambiciet tona kanë qenë edhe më të mëdha për realizimin e shumë detyrave dhe shumë çështjeve që kanë mbet pa u kryer, apo kanë mbet të nisura. Por, edhe roli ynë ka pas qasje të ndryshme nganjëherë, mirëpo krejt këto në suaza të kontekstit demokratik dhe në suaza të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës sonë. Për vlerësimin dhe punën tonë të mëtejme, besoj se së shpejti qytetari do të jap vlerësimin e vetë pasi që jemi në prag të zgjedhjeve. Gjithë atyre kandidatëve dhe gjithë grupeve politike ju uroj suksese në garën që na pret në zgjedhjet lokale. Si dhe uroj që këto zgjedhje të shkojnë në frymë qytetare ashtu siç na ka hije, po ashtu të jemi shembull për gjithë komunat tjera për ndërtimin e një bashkëpunimi të mirëfilltë të qeverisjes, sepse e gjithë kjo është në interesin tonë të përbashkët. Të gjitha të arriturat janë të përbashkëta dhe hyjnë në llogarinë tonë si asamble. Ju faleminderit.

Trandolina Duli: Të nderuar të pranishëm dhe të nderuar qytetarë të Komunës së Fushë-Kosovës. Sot jemi në mbledhjen e fundit të kësaj legjislature të Kuvendit të Komunës, ku për katër vite me radhë unë jam përpjekur që të përfaqësoj interesat e qytetarëve të Fushë-Kosovës në përballje me pushtetin. Duke qenë e vetme si numër, fatkeqësisht, nuk kam arritur t'i ndal shumë punë e veprime, të cilat, të paktën unë personalisht i kam konsideruar si të këqija të pushtetit, e gjithashtu nuk kam arritur t'i shtyj përpara shumë propozime, shumë projekte të mira që do ta përmirësonin mirëqenien e përbashkët. Kam kërkuar respektimin e ligjit dhe shtimin e transparencës, si dhe kam kërkuar publikimin e audioincizimeve në mënyrë që të njoftohen qytetarët me atë se çka po ndodh në mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Pastaj propozimet për reformimin e administratës dhe regjistrimin e banorëve të rinj. Pastaj ndërrimi i formës të buxhetit, ndërrimi i qasjes në shpenzime, duke kursyer buxhetin nga shpenzimet e luksit. Propozimi për skemat e reja për subvencione, propozimet për ndërhyrjet infrastrukturore që e rrisin hapësirën e përbashkët, i japin frymëmarrje qytetit dhe mundësojnë një jetë normale për banorët. Propozimi për sanimin e gjendjes në arsim dhe ringjalljen e kulturës dhe gjithashtu kërkesat e shumta për reformimin e shëndetësisë, me theks të veçantë të një ristrukturimi të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovës. Përveç këtyre me ndihmën dhe kërkesën e qytetarëve kam arritur të sjell në këtë Kuvend tri nisma në formë të peticioneve nga fshatrat Miradi e Poshtme, Bardh i Madh dhe Nakaradë. Kam bërë mbi 100 pyetje parlamentare dhe dhjetëra kërkesa për probleme të ndryshme që kam kërkuar të futen si pika të rendit të ditës në Kuvendin e Komunës por askund nuk kanë pasur gatishmëri për përgjigje. Krejt në fund do të thosha se Fushë-Kosova si qytet, por edhe Kosova si shtet po vazhdon të lëngojë nga keqëqeverisjet ose qeverisja e interesave klanore, që mendjen e kanë tek biznesi individual e jo tek zhvillimi ekonomik dhe ngritja e mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve. Fjala demokraci do të thotë sundim nga populli, ndërsa ne si vend edhe pse në mënyrë të nominuar quhemi demokraci, as nuk e kemi kuptuar dhe aq më pak nuk e kemi realizuar këtë koncept. Ne vazhdojmë të sundohemi nga klanet e interesit që përfundimisht po e

them punojnë për interesa të veta individuale e jo për mirëqenien e përgjithshme. Unë uroj që populli i Kosovës të zgjohet, të bëhet aktiv dhe pjesëmarrës sidomos në protesta e demonstrata, derisa demokracia në vend të jetë demokraci e vërtetë për popullin, për zhvillim, për barazi dhe mirëqenie. Uroj që popullin tonë ta presin ditë më të mira.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Këtu nuk i bëhet thirrje popullit për të dalë në protesta e demonstrata. Ju e keqpërdorët edhe propozimin edhe fjalën.

Naser Gaiçevci: Unë, sot, me kënaqësi dua të them se ky Kuvend dhe ju kolegë të nderuar, edhe ju Kryesues i nderuar, edhe përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it, të cilët na kanë përcjellë çdo mbledhje, keni qenë shembullor. Fjala e secilit këtu, si njëra pjesë e misionit të këtij Kuvendi, me të vërtetë mendoj ka qenë shembullore. Ne si grup më i madh opozitar që nga fillimi e kemi ditë se çka duam, e kemi ditë forcën tonë, qëllimi ynë ka qenë që të përmirësojmë qeverisjen lokale, të përmirësojmë demokracinë lokale. Është ana tjetër fatkeqësisht, që vendimmarrja gjithmonë ka shkuar në bazë të raportit të forcës, që në demokraci është normale. Qeverisja, gjegjësisht partia që qeveris ka programet, politikat dhe projektet e veta, të cilat i ka kaluar gjatë këtij mandati. Prandaj mund të them se një Kuvend i cili përbëhet me një përqindje të madhe të një partie mund të jetë jo produktiv sepse atëherë vjen prepotenca e madhe e partisë, e cila vazhdimisht çon në vendimmarrje. Dhe ne mendojmë që vendimmarrja shumë herë ka qenë e gabuar, nuk ka qenë në dobi të qytetarëve, ka qenë me premisa të interesave të caktuara dhe kjo është një shije që nuk kisha dashur të përsëritet në qeverinë e ardhshme të këtij Kuvendi. Secili nga ju që do të kandidoni, vërtetë kam dëshirë të jeni prapë në përbërje të këtij Kuvendi. Unë mendoj që e meritoni këtë sepse keni treguar vlerë të lartë në debate, diskutime dhe mbi të gjitha keni treguar që e keni atë më të rëndësishmen, sjelljen njerëzore, të cilën, kemi nevojë ta kultivojmë vazhdimisht. Kandidatëve që janë në listë për asambleistë ju uroj shumë suksese, ndërsa ata që nuk janë dua t'i falënderoj për zemërsisht për bashkëpunimin që kanë ofruar gjatë këtij mandati. Urime, shëndet të gjithëve!

Miroslav Veličković: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ka qenë nder dhe respekt të punoj këto katër vite si përfaqësues i Komitetit për Komunitete. Tani kur po e përmbyllem këtë mandat unë kam vetëm fjalë miradije për ju, anëtarë të Kuvendit të Komunës, Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës. Në emër të subjektit tim politikë që e përfaqësoi jemi të kënaqur me punën dhe rezultatet e punës, është punuar shumë në infrastrukturë dhe fusha tjera, kërkesa ime është që në të ardhmen të ndahen më shumë mjete financiare në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe për sportin. Të gjithëve kandidatëve që janë në garën e 'zgjedhjeve lokale të 22 tetorit', ju uroj suksese.

Aida Alimi: Të nderuar të pranishëm unë dëshiroj t'ju falënderoj të gjithëve veç e veç për sjelljen tuaj në Kuvendin e Komunës, për sjelljen e mirë kolegjiale që kemi patur. Gjatë këtij mandati katër vjeçar nuk kam marr asnjë përgjigje të vetme për gjithë ato pyetje që i kam shtruar. Besoj se në të ardhmen, legjislativi apo ekzekutivi i ardhshëm do të ketë një përkushtim më të madh në lidhje me obligimet e tyre ligjore, sepse qytetarët e Fushë-Kosovës me të vërtetë e meritojnë një qeverisje më të mirë dhe më të përgjegjshme.

Milaim Berjani: Përshëndetje për të gjithë. Ju njoftoj se unë nuk jam në listë për asamble. Unë kam kërkuar që të bëhet renovimin e shkollës së vjetër, mirëpo nuk kam pasur përkrahje, po ashtu

kam kërkuar edhe një klasë parashkollore por nuk kam pasur përkrahjen tuaj. Vota ime dhe e familjes sime është për LDK-në. Ju faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë dua t'ju flas për përvojën time që e kam pasur në këtë Kuvendet e Komunës prej zgjedhjeve të para deri më tani. Herëve tjera kam qenë drejtor dhe është dashur të raportoj para këtij Kuvendit. Ka pasur zëra në Fushë-Kosovë që ky Kuvend nuk është merituar, nuk është Kuvend i fuqishëm. Unë po ju them që ky Kuvend ka qenë shumë i fuqishëm në krahasim me të gjitha kuvendet tjera, përveç një Kuvendi, të cilin nuk mund ta harroj, ku ka qenë prezent një opozitë shumë e fortë, me asambleistë si Adem Zogjani, Naser Graicevci, Shaban Ademi, Zijadin Bajcinca, Ibrahim Berisha, Ibush Kelmendi asamblistët e tjerë prej LDK-së që kanë qenë në atë Kuvend. Ai ka qenë një Kuvend të cilin mund ta krahasoj përafërsisht me këtë Kuvend. Arsyeja është shumë e thjeshtë, një pozitë që ka qenë shumë e disiplinuar, një opozitë që ka qenë shumë aktive dhe shumë e përgjegjshme për të gjitha diskutimet dhe fjalën që e ka thënë këtu, e cila ka pas ndikim shumë të madh edhe në ekzekutiv. Pa marr parasysh që nuk janë plotësuar disa kërkesa të opozitarëve siç është kërkesa për incizimet e Kuvendit. Unë ju falënderoj sepse keni qenë shumë konstruktiv, keni qenë opozitë e cila nuk e keni dëgjuar shumë administratën publike, keni pas qëndrimet tuaja në krahasim me opozitat tjera. Dëshiroj që edhe në të ardhmen, edhe Kuvendi tjetër që vjen të jetë i njëjtë në të dy aspektet, por me disa përmirësime konkrete. Në veçanti që kurrë mos të ndodh që të flitet vetëm për vete, mirëpo të flitet për të mirën e qytetarëve, të flitet se si të ngritet cilësia e jetesës së qytetarëve të Fushë-Kosovës. Sot u përmend shumë demokracia. Nëse e kuptojmë të vërtetën e demokracisë, demokracia nganjëherë është shumë e rëndë sepse llogaritet që është si një masë e baltës që rrëshqet, kënd e zë e fundos. Duhet të përpiqemi që ajo demokraci të jetë më njerëz të vërtetë, të cilët janë profesionist dhe të cilët i kuptojnë proceset, e jo me njerëz që mendojnë vetëm për vete dhe për një grup të caktuar të njerëzve. Ju falënderoj për bashkëpunim dhe kërkoj falje nëse ndonjëherë kam qenë i ashpër ndaj dikujt, mirëpo megjithatë është një mes të cilin duhet me disiplinë pak, për hir të tjerëve sepse unë kam qenë Kryesues i këtij Kuvendi dhe është dashur të mbaj një rend. Të gjithë atyre që janë kandidat për asambleistë ju uroj suksese. Falënderoj edhe komunitetet në Fushë-Kosovë sepse kanë qenë gjithmonë konstruktiv dhe uroj që edhe në mandatin tjetër të vazhdojnë të njëjtën rrugë. Gjithë atyre që janë në garë për Kryetar të komunës ju uroj suksese, të zgjidhet ai që e meriton, ai që është më i miri. Dhe ju e dini kush është më i miri. Faleminderit!

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e 'Raportit financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim Propozimin për shqyrtimin e 'Raportit financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017', ftoj Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori i FB: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, është bërë nga dy burime të financimit, grantet e qeverisë dhe të hyrat vetjake, të gjitha shpenzimet janë të paraqitura në formën analitike. Në administratë buxheti i alokuar është në shumë prej: 4,250,421.95€, buxheti i shpenzuar është 1,317.142.72€,

buxheti i zotuar është 12,196.61€ dhe buxheti i mbetur është 4,876,973.46€, në arsim buxheti i alokuar është në shumë prej: 1,899,401.81€, buxheti i shpenzuar është 1,476,734.33€, buxheti i zotuar është 2,000.00€ dhe buxheti i mbetur është 2,082,551.93€, në shëndetësi buxheti i alokuar është në shumë prej: 719,220.03€, buxheti i shpenzuar është 513,472.08€, buxheti i zotuar është 4,500.00€ dhe buxheti i mbetur është 919,360.79€, në Zyrën e Komuniteteve buxheti i alokuar është në shumë prej: 18,000.02€, buxheti i shpenzuar është 14,119.62€, buxheti i zotuar është 500.00€ dhe buxheti i mbetur është 20,004.38€. Buxheti fillestar i aprovuar nga Kuvendi i Komunës ka qenë në shumë prej: 9,540,835.40€, ndërsa kur i janë bashkuar edhe mjetet e bartura financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2016, ka arritur në shumën e përgjithshme prej: 11,238,555.92€. Buxheti i alokuar është në shumë prej: 6,887,043.81€, ndërsa buxheti i shpenzuar është 3,321,503.75€, ose 48%, buxheti i zotuar është 19,196.61€. Raporti ndërmjet buxhetit të alokuar dhe buxhetit të shpenzuar si total është 30%, ndërsa nga të hyrat vetjake të planifikuara janë realizuar 1,239,011.79€ ose 41%.

Nazmi Kelmendi: Besoj që të gjithë jemi të vetëdijshëm për disa çështje lidhur me shpenzimin e buxhetit. Në bazë të pasqyrimin që e bëri Drejtori për Financa dhe Buxhet ne mendojmë se ky raport është menagjuar sipas ligjit dhe dinamikës së paraparë dhe sipas kodeve ekonomike. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së propozoj që ‘Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017’, të aprovohet.

Naser Graiçevci: Vetëm 30% kemi shpenzim të buxhetit, kjo me të vërtetë është brengosëse. Qytetarët nuk e meritojnë shpenzimin e buxhetit në këtë formë. Janë 11 milion euro ndërsa ne i kemi shpenzuar vetëm 3 milion euro, kjo është e pa tolerueshme, prandaj në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës kemi thirr për kreativitet të kësaj qeverisje.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për shqyrtimin e ‘Raportit financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017’.

U votua me: katërmëdhjetë vota ‘për’, gjashtë ‘kundër’ dhe një ‘abstenim’, gjithsej njëzet e një (21) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi ‘Raportin financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017’ dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar për periudhën Janar/Qershor 2017 në Komunën e Fushë-Kosovës, në shumë të përgjithshme prej 3,321,503.75€.
2. Buxheti i shpenzuar nëpër kategoritë ekonomike është si vijon:
 - 2.1 Për rroga dhe paga, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 2,213,081.34€;
 - 2.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 180,291.19€;
 - 2.3 Për shpenzime komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 64,518.25€;
 - 2.4 Për subvencione dhe transfere, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 123,007.12€;
 - 2.5 Për pasuritë jofinanciare investime kapitale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 740,605.75€.

Pika e katërt (4) - Propozim për shqyrtimin e Buxhetit të Planifikuar për vitin 2018.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e Buxhetit të Planifikuar për vitin 2018', ftoj Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori i FB: Përveç punëve të përditshme që i ka Drejtoria për Financa dhe Buxhet, ne jemi marrë edhe me hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2018-2020. Ne kemi marrë edhe kufijtë buxhetorë nga Ministria e Financave ku në bazë të qarkores kemi qenë të obliguar t'i ndjekim hapat e përgatitur nga ky dokument në bashkëpunim me secilin drejtor për hartimin e kornizës afatmesme të shpenzimeve për t'ia prezantuar ato më pas Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe në Kuvendin e Komunës. Me miratimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve sipas agjendës ne si Drejtori e Financave dhe Buxhetit mbajmë tri dëgjime publike. Në dy dëgjimet e para numri i të pranishmëve ka qenë shumë më i madh, ndërsa në dëgjimin e tretë numri ka qenë më i vogël. Po ashtu, kemi mbajtur një debat edhe me OSBE-në. Ne kemi kërkuar që në arsim dhe në shëndetësi ta rrisim numrin e të punësuarëve, pasi që arsimi dhe shëndetësia kanë shumë nevojë për këtë rritje, mirëpo nuk na kanë pranuar. Për vitin 2018 kemi grantet qeveritare në shumë prej: 7,488,636.00€, ndërsa të hyra vetjake janë në shumë prej: 2,723,185.00€, kurse buxheti i përgjithshëm për vitin 2018 është 10,211,821.00€, nga kjo shihet që ka një rritje prej 10% viti të kaluar.

Nazmi Kelmendi: Ky dokument i plotëson të gjitha kriteret dhe zbaton të gjitha procedurat për planifikimin e buxhetit. Janë ndjekur të gjitha aspektet financiare të parapara me udhëzime dhe qarkoret buxhetore, buxheti është gjithëpërfshirës dhe parasheh realizimin e projekteve kapitale dhe vitale të komunës sonë, për qytetin e Fushë-Kosovës dhe secilin fshat. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së propozoj që buxheti i planifikuar për vitin 2018, të aprovohet.

Naser Graiçevci: Ky planifikim buxhetor nuk do t'iu jap qytetarëve një dokument përmbajtësor, me plane dhe projekte të cilat përmirësojnë jetën e tyre të përditshme. Nëse ky plan dhe buxheti realizohet në këtë mënyrë edhe në këto tre vite, qytetarët e Fushë-Kosovës nuk do të kenë më shumë hapësira të lira për fëmijë, nuk do të kenë më shumë trotuare, nuk do të kenë më shumë parkingje dhe nuk do të kenë më shumë siguri në rrugë. Në këtë planifikim nuk janë paraparë nënkalimet që janë aq të rëndësishme për qytetarët e Fushë-Kosovës, sidomos për dy pjesët e rrugës magjistrale. Nuk është bërë zgjidhje të rrethrotullimi në Fushë-Kosovë, ku bëhet tollovi e madhe në trafik, d.m.th. prapë do të jemi me të njëjtat probleme dhe brenga. Ky buxhet nuk ofron një perspektivë zhvillimore, nuk ofron një rishqyrtim të skemës së subvencioneve, nuk ofron një mundësi më të madhe të punësimit përmes derdhjes së të hyrave publike në shërbim të zhvillimit ekonomik. Unë shpresoj se qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës do të reflektojnë me 22 tetor dhe reflektimi i tyre do të na jap një legjislaturë e cila do të jetë më e kombinuar dhe me mundësi më të mëdha vendimmarrëse, në formën e një demokracie të zhvilluar dhe jo në këtë formë qysh e kemi pas deri më tani.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne mendojmë se ky buxhet është buxhet optimal. Një buxhet optimal i cili i kryen funksionet të cilat duhet me qenë. Nëse e shikoni mirë e kryen funksionin fiskal sepse grumbullohen ato mjete që parashihen, funksionin ekonomik duke bërë rishpërndarjen e mjeteve sipas prioriteteve që duhen dhe funksionin social duke ju dhënë ndihma të ndryshme qytetarëve, qoftë përmes bursave, qoftë përmes subvencioneve, qoftë përmes ndihmave tjera.

Është një buxhet optimal në kushtet e Komunës së Fushë-Kosovës. Ne si pozitë mendojmë që është një buxhet i mirë. Ndërsa, nëse opozita vjen në pushtet ka mundësi ta ndryshoj këtë buxhet, sepse rishikimi i buxhetit bëhet në vitin tjetër dhe ata mund ta ndryshojnë dhe ta vendosin sipas prioriteteve të veta. Në këtë buxhet është paraparë që në automjetet e Komunës të Fushë-Kosovës të vendosen edhe GPS-i, në mënyrë që të përcillen të gjitha lëvizjet e makinave. Në mandatin tjetër ekzekutivi obligohet që t'i vendos këto aparatura në makinat të cilat do të lëvizin në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pasi që diskutime dhe plotësime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për aprovimin e 'Buxhetit të Planifikuar për vitin 2018'

U votua me: gjashtëmbëdhjetë 16 vota 'për', gjashtë 'kundër' dhe një 'abstenim', gjithsej njëzet e tre (23) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Buxhetin e Planifikuar për vitin 2018' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2018, në shumë të përgjithshme prej 10,211,821.00€, i shpërndarë nëpër programe e nënprograme të kategorive ekonomike si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe mëditje për 720 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 4,516,961.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 840,299.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunale, buxheti i komunës është në shumë prej: 150,000.00€;
 - 1.4 Për subvencione e transfere, buxheti i komunës është një shumë prej: 274,675.00€;
 - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 4,429,886.00€.

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i dytë i 'Projekt-Planit për zhvillimin e arsimit 2017-2019'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ky është shqyrtimi i dytë i 'Projekt-Planit për zhvillimin e arsimit 2017-2019', nuk po ja jap fjalën Drejtorit të Arsimit, për arsye se e ka sqaruar këtë plan në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa. Hap diskutimin.

Nazmi Kelmendi: Është çështje e njohur për neve, sepse ky është shqyrtimi i dytë. Është një plan zhvillimor i arsimit për periudhën 2017-2019, i cili, konsideroj se i plotëson të gjitha procedurat.

Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së, propozoi që i njëjti të aprovohet.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Projekt-Planin për zhvillimin e arsimit 2017-2019'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e 20 anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës unanimisht e miraton:

'Planin për zhvillimin e arsimit në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën trevjeçare 2017-2019'.

Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i dytë i 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ky është shqyrtimi i dytë i 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'. Hap diskutimin.

Fazile Sejdiu: Dëshiroj të falënderoj të gjithë kolegët e mi për durimin që kanë pasur, për të dëgjuar diskutimet e mia, gjatë këtyre katër viteve të mandatit. Unë gjithashtu kam qenë dhe jam për t'i mbështetur qytetarët rreth shqetësimeve të tyre si dhe për të respektuar ligjin. Po ashtu, të gjithë atyre që janë në lista zgjedhore iu dëshiroj sukses. Ndërsa, sa i përket pikës së gjashtë të rendit të ditës 'Shqyrtimi i dytë i Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. Fatmir Krasniqi', unë personalisht jam kundër duke e marr parasysh faktin që nuk janë respektuar disa procedura. E para, Projekt-Statuti nuk është diskutuar me asnjë punëtorë të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, edhe pse ka dalur në diskutimin publik. Duke filluar prej pastruesit e deri te drejtori, punëtorët shëndetësor nuk e kanë idenë se çfarë po ndodh dhe çfarë ka të bëjë me këtë statut. E dyta, nuk është respektuar procedura sa i përket Kuvendit të Komunës. Në Kuvend anëtarët e tij nuk e kanë marrë Projekt-Statutin origjinal, i cili ka ardhur nga Ministria e Shëndetësisë. Qoftë ai Projekt-Statut komplet i përputhur me statutin që na ka ardhur neve ose i përpunuar nga Këshilli Drejtues, mirëpo ne nuk e kemi marrë dhe nuk e dimë se çka është punuar, e çka nuk është punuar në të. E treta, nuk është respektuar Komiteti për Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale, i cili ka dal nga ky Kuvend. Anëtarët e këtij Komiteti kanë punuar për hartimin e kompetencave dhe përgjegjësi të Komitetit për Shëndetësi. Disa prej këtyre kompetencave janë: Anëtarët e Komitetit për Shëndetësi duhet të jenë pjesëmarrës në hartimin e Rregulloreve të brendshme të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, asnjëherë nuk ka pas ftesë për diçka të tillë, anëtarët e Komitetit për Shëndetësi duhet të jenë pjesëmarrës gjatë ndarjes së subvencioneve për shëndetësi, asnjëherë nuk kemi pas ftesë. Tash në fund, kur bëhet hartimi i një Projekt-Statuti, sipas të cilit duhet të punojë Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe krejt shëndetësia në Komunën e Fushë-Kosovës, nuk janë thirr profesionistët për të dhënë mendimin e tyre, qoftë për ta mbështetur, qoftë për ta kundërshtuar apo për të dhënë opinione tjera të ndryshme prej asaj që është hartuar këtu. Prandaj, në bazë të këtyre shkeljeve të procedurave, pa pasur asgjë personale, unë jam kundër këtij Projekt-Statuti.

Nazmi Kelmendi: Konsideroj që ne kemi pasur hapësirë dhe kemi pasur mundësi për ta dhënë kontributin tonë. Është dashur që në vazhdimësi, me kohë, t'i japim të gjitha vërejtjet, e jo tash kur jemi në fazën finale. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së, propozojmë që ky Statut të aprovohet.

Remzi Shala: Përshëndetje për të gjithë, si dhe ju falënderoj për kontributin e dhënë gjatë këtyre katër viteve. Unë mendoj se asambleistët nga radhët e shëndetësisë kanë qenë aktiv gjatë këtyre viteve dhe kanë punuar shumë në të mirë të shëndetësisë. Të gjithë jemi munduar të bëjmë më të mirën për shëndetësinë në komunën tonë, duke filluar prej Drejtorisë së Shëndetësisë, Këshillit të Shëndetësisë si dhe punëtorëve shëndetësorë, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm me punën e tyre. Po ashtu, i përgëzoj të gjithë ata të cilët e kanë shpreh guximin e tyre për të kërkuar votën e qytetarëve. Unë personalisht mendoj që emri i Qendrës Kryesore të Mjekësisë

Familjare nuk duhet të ndërrohet, përndryshe unë do të jem kundër. Në Projekt-Statutin që ka ardhur nga Ministria e Shëndetësisë emri i institucionit shkruhet: QKMF Fushë-Kosovë; Ndërsa unë dëshiroj që statuti që dërgohet në Ministrinë e Shëndetësisë, emri i institucionit duhet të jetë: QKMF 'Dr. Fatmir Krasniqi', Fushë-Kosovë. Nëse aprovohet kështu unë votoj, përndryshe unë jam kundër. Unë jam pjesë e Këshillit Drejtues, i cili, e ka aprovuar këtë Projekt-Statut. Si njëri prej pjesëtarëve që e ka shqyrtuar si dhe e ka aprovuar këtë Projekt-Statut, unë kam vërejtje për shkak që nuk është thirrur Komiteti për Shëndetësi për hartimin e këtij Statuti dhe në këtë mënyrë kanë mbetur dyshime te asambleistët. Themeluesi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare është Kuvendi i Komunës Fushë-Kosovë, besoj që edhe këtu është një gabim teknik dhe kërkoj që të jetë e shënuar me shkrim që Drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare zgjidhet në përputhje me Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, me konkurs të shpallur nga themeluesi, jo, konkursi për drejtor nuk shpallet nga Kuvendi por duhet të shpallet nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe këtu kërkoj që të përmirësohet, se pastaj mund të dalin probleme juridike nëse aprovohet kështu. Më tej thuhet, drejtorin e zgjedh Drejtoria për Shëndetësi, krejt në rregull, por edhe konkursin duhet ta shpall Drejtoria e Shëndetësisë, e jo Kuvendi i Komunës. Dhe për fund, në bazë të kësaj strukture organizative që e kemi në shëndetësi jam i bindur se në të ardhmen do të kemi implikime buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju falënderoj për kontributin që e dhatë, dy doktorët, mirëpo ju het ta dini që ky statut është unik për gjithë Kosovën. Ky statut edhe pasi të aprovohet këtu, do të shkoj në Ministrinë e Shëndetësisë dhe do të shikohet, nëse nuk është në harmoni me Ministrinë e Shëndetësisë do të kthehet prapa për ta rishqyrtuar.

Fazile Sejdiu: Vërejtjet dhe shqetësimet tona janë se janë shkel procedurat, nuk është konsultuar fare Komiteti për Shëndetësi.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.

U votua me: shtatëmbëdhjetë 17 vota 'për', katër 4 'kundër' dhe asnjë 'abstenim', gjithsej njëzet e një (21) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e miraton:

'Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.

Pika e shtatë (7) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për Shërbyesin Civil Sahit Sopjani.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozim për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për Shërbyesin Civil Sahit Sopjani'. Propozoj që t'i bashkojmë tri pikat e fundit për diskutime, pasi që kanë natyrën e njëjtë, ndërsa vendimet i marrim veç e veç. Hap diskutimin.

Nazmi Kelmendi: Ne si Grup Parlamentar e përkrahim mundësinë e pensionimit të parakohshëm, pasi që e dimë gjendjen e tyre shëndetësore, mirëpo kjo procedurë duhet të bëhet në kuadër të ligjeve ekzistuese në mënyrë që mos të biem ndesh me ligjin. Ju dëshirojmë shëndet edhe sukses.

Naser Graiçevci: Ne, vetëm duam të dimë interpretimin, a është e mbështetur në ligj apo jo?

Milaim Berjani: Njëri prej këtyre punëtorëve, Ramadan Bislimi, është shoku im, i cili më ka kërkuar që t'iu pyes se si do të bëhet pagesa, pasi që atij i duhen këto mjete për barna dhe për shërim. A do të jetë për çdo muaj, apo në ndonjë mënyrë tjetër?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pensionimi i parakohshëm lejohet prej moshës 63 vjeçare, pagesa bëhet me 70% të pagës, këto pagesa bëhen për çdo muaj, mirëpo nëse ka fuqi financiare Komuna mund t'ia jap të gjitha përnjëherë.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për Shërbyesin Civil Sahit Sopjani'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet (20) anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për Shërbyesit Civil Sahit Sopjani' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit Nr. 908, të datës 11.09.2017, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 10,882.54€, për pagesën e pensionimit të parakohshëm për Shërbyesin Civil z. Sahit Sopjani, i lindur me datën 01.01.1955, me vendbanim në fshatin Harilaç, i caktuar në vendin e punës Zyrtar për Arkiv në Shtëpinë e Kulturës, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Pika e tetë (8) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për Shërbyesin Civil Adem Kutllovci.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për Shërbyesin Civil Adem Kutllovci'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet 20 anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për Shërbyesit Civil Adem Kutllovci' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit Nr. 909, të datës 11.09.2017, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 11,610.40€, për pagesën e pensionimit të parakohshëm për Shërbyesin Civil z. Adem Kutllovci, i lindur me datën 30.06.1954, me vendbanim në fshatin Bardh i Madh, i caktuar në vendin e punës Zyrtar për Kulturë në Shtëpinë e Kulturës, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Pika e nëntë (9) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për punëtorin arsimor Ramadan Bislimi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për punëtorin arsimor Ramadan Bislimi'.

U votua unanimitet nga të pranishmit, gjithsej 20 anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për pensionimin e parakohshëm për punëtorin arsimor Ramadan Bislimi' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit Nr. 882, të datës 04.09.2017, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 6,677.84€, për pagesën e pensionimit të parakohshëm për punëtorin arsimor z. Ramadan Bislimi, i lindur me datën 06.10.1953, me vendbanim në fshatin Miradi e Epërme, i caktuar në vendin e punës mësimdhënës klasor, në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Vëllezërit Frashëri' në fshatin Miradi e Epërme, në kuadër të Drejtorisë së Arsimit.


Pika e dhjetë (10) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani ju ftoi të gjithëve anëtarët e Kuvendit të Komunës që kanë shërbyer në mandatin zgjedhor 2013/2017, në një drekë zyrtare në Anabenz.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 11.25 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Dr.sc. Fadil Krasniqi

